



VENDIMI DHE GJETJET

Data e miratimit: 11 dhjetor 2020

Nr. i lëndës: 2016-11

Anđelija Brakus

kundër

EULEX-it

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur më 11 dhjetor 2020, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Z. Guénaél METTRAUX, kryesues
Z. Petko PETKOV, anëtar zëvendësues
Znj. Anna AUTIO, anëtare

Ndihmuar nga:

Z. Ronald Hooghiemstra, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në pajtim me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe Rregullores së Punës së Panelit, e ndryshuar për herë të fundit më 11 dhjetor 2019,

Pas shqyrtimit përmes mjeteve elektronike, në përputhje me Rregulloren 13(3) të Rregullores së Punës së Panelit, u vendos si në vijim:

I. PROCEDURAT PRANË PANELIT

1. Ankesa në këtë lëndë është regjistruar në Panel më 30 qershor 2016.
2. Më 27 qershor 2017, Paneli ka kërkuar nga ankuesi të ofroj informata shtesë në lidhje me ankesën.
3. Më 20 tetor 2017, Paneli ka pranuar informata shtesë në lidhje me lëndën si përgjigje ndaj kërkesës.

4. Më 8 dhjetor 2017, Paneli i transmetoi një Deklaratë të Fakteve dhe Pyetjeve shefit të Misionit (ShM), EULEX-i Kosovë, duke e ftuar shefin e Misionit të atëhershëm të paraqesë përgjigjet e saj dhe vërejtjet me shkrim mbi ankesën jo më vonë se 26 janari 2018.
5. Me anë të një letre të 17 janarit 2019, Misionit iu kërkua përsëri të sigurote përgjigje në pyetjet e paraqitura nga Paneli deri më 16 shkurt 2019.
6. Me një letër të datës 8 prill 2019, Paneli përsëri i kërkoi ShM-së që të sigurojë përgjigje në pyetjet sa më shpejt që ishte e mundur.
7. Më 19 prill 2019, ShM-ja paraqiti vërejtje mbi pranueshmërinë e ankesës.
8. Më 26 prill 2019, vërejtjet e ShM-së iu dërguan ankueses dhe ajo u ftua të paraqesë komentet e saj, nëse ka pasur, deri më 26 maj 2019. Ankuesja nuk e shfrytëzoi këtë mundësi.
9. Më 11 shtator 2019, Paneli e gjeti këtë lëndë të pranueshme në lidhje me pretendimet për shkelje të neneve 2, 3, 8 dhe 13 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut ("Konventa"). Në atë vendim, Paneli më tej u kërkoi palëve që të adresojnë pyetjet vijuese:

1. **Ankuesi:** Ju lutemi jepni informacion në lidhje me sa vijon:

- i. Çfarë kontakti, nëse ka, keni pasur me Misionin e EULEX-it ose përfaqësuesit e tij? Nëse po, kur? Nëse jo, pse?
- ii. A jeni në dijeni rreth ndonjë përpjekjeje të autoriteteve vendore për të hetuar këtë rast?
- iii. A ka shkelur apo kontribuar Misioni në shkeljen e të drejtave të ankuesit sipas neneve 2, 3, 8 dhe 13 të Konventës? Nëse po, në çfarë mënyre?
- iv. Cilat janë pasojat - personale, financiare, ligjore dhe emocionale - që lidhen me zhdukjen e të afërmit tuaj?

2. **Misioni:** Ju lutemi jepni informacion në lidhje me sa vijon:

- i. A ishte marrë zyrtarisht ndonjë vendim për të mos hetuar këtë rast? Nëse po, kur dhe nga kush?
- ii. Çfarë hapash, nëse ka, kishte marrë Misioni për të hetuar këtë rast?
- iii. Çfarë kontakte, nëse ka, kishte pasur Misioni me të afërmit e të zhdukurve dhe ankuesin në veçanti?
- iv. Çfarë informacioni, nëse ka, në lidhje me përpjekjet hetimore, kur dhe në çfarë mënyre i kishte ofruar Misioni të afërmit të të zhdukurve?
- v. Nëse Misioni nuk ka ofruar asnjë informacion, pse jo?
- vi. A ishte transferuar dosja e lëndës që kishte të bënte me këtë çështje tek autoriteteve vendore? Nëse po, kur?

10. Palëve iu kërkua të paraqesin parashtrimet e tyre në lidhje me pyetjet e mësipërme jo më vonë se 11 nëntori 2019.
11. Përmes porosisë elektronike të datës 9 tetor 2019, Misioni kërkoi një zgjatje të afatit që ai të paraqesë vërejtjet e tij. Në të njëjtën ditë, Paneli zgjati afatin deri në 11 dhjetor 2019.
12. Më 2 dhjetor 2019, ushtruesi i detyrës së ShM-së paraqiti komente shtesë mbi meritat e ankesës.
13. Më 3 dhjetor 2019, komentet e ushtruesit të detyrës së ShM-së iu dërguan ankuesit për informacion.
14. Në një datë të paspecifikuar në fillim të vitit 2020, Paneli mësoi se ankuesja, znj. Anđelija Brakus, kishte vdekur dhe se djali i saj, z. Petar Brakus, ishte i interesuar të vazhdonte me ankesën.
15. Më 4 mars 2020, Paneli kërkoi nga z. Brakus që të informonte Panelin me shkrim për vdekjen e nënës së tij dhe të konfirmonte interesin e tij për të vazhduar me ankesën. Z. Brakus u kërkua të siguronte këtë konfirmim deri në 4 prill 2020.
16. Për shkak të pandemisë së virusit korona dhe që rezutoj me pezullimin e shërbimeve postare në Kosovë, ankuesi nuk ishte në gjendje të përgjigjej brenda afatit të caktuar.
17. Më 10 shtator 2020, z. Brakus paraqiti konfirmimin e tij zyrtar për të pasuar nënën e tij si ankuese në këtë rast. Paneli konsideron që rrethanat e përshkruara më sipër përbëjnë një arsye të mirë dhe justifikojnë zgjatjen e afatit të dhënë.

II. QËNDNDRIMI I ANKUESIT

18. Duke marrë parasysh marrëdhëniet e ngushta familjare midis viktimës kryesore, ankuesit fillestar dhe ankuesit të ri - d.m.th. babait dhe nënës dhe djalit të tyre - Paneli është i bindur që ankuesi i ri mund të pasojë ankuesin fillestar dhe mund të konsiderohet si viktimë dytësore e shkeljeve të pretenduara dhe, si e tillë, viktimë e mundshme në përputhje me rregullën 25(1) të rregullores së punës së Panelit.

III. FAKTET

19. Faktet e lëndës, siç paraqiten nga ankesa, mund të përmbliidhen si më poshtë.
20. Më 22 qershor 1999, Dušan Brakus, babai i ankuesit, Petar Brakus, së bashku me dhëndrin e tij, vizituan fshatin Nedakoc, Komuna e Vushtrrisë, për të shqyrtuar gjendjen e shtëpisë së tij. Sipas dhëndrit të tij, ata u sulmuan nga fshatarët vendas dhe dhëndri arriti të ikë në makinë, duke lënë vjehrrin e tij prapa. Kjo ishte e fundit që familja e tij dëgjoji për fatin e Dušan Brakus-it.
21. Zhdukja e tij ishte raportuar në një numër institucionesh ndërkombëtare dhe vendore që merreshin me persona të zhdukur. Në veçanti, bashkëshortja e tij kishte raportuar zhdukjen e tij në UNMIK dhe KFOR në Prishtinë në ditën kur ai ishte zhdukur. Familja e tij gjithashtu raportoi menjëherë zhdukjen e tij tek autoritetet serbe në Kraljevë, Republika e Serbisë, si dhe në Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq dhe gjithashtu në Shtabin e KFOR-it dhe Xhandarmërinë franceze në Mitrovicë.

22. Në dy raste, ankuesit iu kërkua të rishikojë eshtrat njerëzore dhe ai gjithashtu dha një mostër gjaku në 2002 për identifikimin e mundshëm të ADN-së, por trupi i babait të tij nuk është gjetur.

IV. PARASHTRIMET E PALËVE

Ankuesi

23. Ankuesi pretendon se, gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv, Misioni duhej të kishte hetuar zhdukjen e babait të tij dhe me faj nuk kishte arritur ta bënte këtë, duke i shkëlur të drejtat e tij themelore.

Shefi i Misionit ("ShM")

24. Parashtrësat e Misionit mbi meritat e kësaj lënde u morën më 2 dhjetor 2020.
25. Në përgjigje të pyetjes së Panelit nëse ishte marrë një vendim zyrtar nga Misioni për të mos hetuar këtë rast, Misioni u përgjigj se asnjëherë nuk kishte marrë ndonjë vendim zyrtar për të mos hetuar këtë zhdukje specifike. Misioni shtoi se:

'Burimet e EULEX-it Kosovë nuk ishin të pakufizuara dhe do të kishte qenë e paarsyeshme dhe joefektive të hetoheshin të gjitha rastet e krimeve të luftës dhe krime të tjera të rënda në lidhje me konfliktin në të njëjtën kohë; prandaj, Misionit iu desh domosdoshmërisht t'i jepte përparësi lëndëve të caktuara mbi ato të tjera. Mos hetimi i kësaj çështje ishte pasojë e vendimit të Misionit për t'i dhënë përparësi dosjeve të krimeve të luftës 'mbi dosjet e personave të zhdukur'. Siç tregohet në vëzhgimet fillestare të Misionit mbi pranueshmërinë e ankesës të datës 19 prill 2019, në momentin e dorëzimit të EULEX-i të *Njësisë së UNMIK-ut për Krimet e Luftës - Raporti i Hetimit Ante-Mortem* për Dušan Brakus, lënda u regjistrua në një bazë të të dhënave të UNMIK-ut; EULEX-i dëshiron të specifikojë që baza e të dhënave në fjalë është baza e të dhënave e personave të zhdukur', jo baza e të dhënave të krimeve të luftës'.

Gjatë kohës së UNMIK-ut, raportet e 'personave të zhdukur' duket se janë hetuar nga Policia e UNMIK-ut vetëm për të përcaktuar vendndodhjen, ose vdekjen e atyre që raportohen të zhdukur. Një numër i madh i raporteve të personave të zhdukur, ka shumë të ngjarë që shumica e tyre, asnjëherë nuk janë dorëzuar në Departamentin e Drejtësisë të UNMIK-ut, i cili në atë kohë ushtronte funksione prokuroriale, ose gjithsesi i hetuar si krime të mundshme të luftës ose krime të tjera të rënda; ata mbetën joaktiv për vite me radhë në një lloj paqartësie ligjore dhe më pas u transferuan në EULEX. Është e rëndësishme të kujtojmë se gjithashtu një sasi e madhe e dosjeve të krimeve të luftës 'ishin lënë në një situatë të ngjashme të paqartësisë ligjore para dorëzimit në EULEX. Siç është shpjeguar tashmë, kjo gjendje e keqe e lëndëve të kërkua në muajt e parë të vitit 2009, shqyrtimi dhe vlerësimi nga Policia e EULEX-it dhe autoritetet ndjekëse të rreth 1,200 kallëzimeve penale, shumica prej tyre joaktive. '

26. I pyetur se çfarë kontakte kishte Misioni me familjarët e të zhdukurve, Misioni u përgjigj se nuk dukej të kishte pasur kontakte me ankuesin ose anëtarët e tjerë të familjes së të zhdukurve.

27. Misioni shpjegoi se nuk u dha familjarëve të të zhdukurve ndonjë informacion në lidhje me këtë rast sepse,

'Siç tregohet në vërejtjet [mbi pranueshmërinë] e datës 19 prill 2019, si pjesë e dorëzimit nga ana e UNMIK-ut, EULEX-i pranoi rreth 5,000 dosje të "personave të zhdukur". Duke pasur parasysh burimet e kufizuara në dispozicion, nuk ishte e mundur të informoheshin në mënyrë aktive të gjithë familjarët e personave të zhdukur ose të vlarë për atë informacion që Misioni kishte dhe nëse lënda po hetohej apo jo.'

28. Për sa i përket nëse dosja e lëndës në lidhje me këtë rast u është transmetuar autoriteteve vendore, Misioni deklaroi se,

'Të gjitha dokumentet që kanë të bëjnë me zhdukjen e Dušan Brakus-it, të cilat ishin mbajtur nga Njësia për Hetimin e Krimeve të Luftës të EULEX-it - NJHKL i janë dorëzuar Policisë së Kosovës në një moment në fund të vitit 2018'.

29. Për sa i përket nëse Misioni kishte shkelur të drejtat e ankuesit sipas neneve 2, 3, 8 dhe 13 të Konventës, Misioni së pari e bën të qartë se nuk e konteston kompetencën *ratione materiae* të Panelit mbi këtë lëndë. Sidoqoftë, Misioni përsërit bindjen e tij se vlerësimi i Panelit për sjelljen e Misionit sipas këtyre dispozitave të Konventës në lidhje me zhdukjen specifike të Dušan Brakus-it duhet të marrë parasysh rrethanat në të cilat Misioni u thirr për të zbatuar mandatin e tij.

30. Misioni fton Panelin në veçanti të marrë parasysh:

- a) shkalla e krimeve në fjalë (në veçanti, fakti që konflikti ka rezultuar ndoshta deri në 13,000 viktima) që do të thotë se jo të gjitha krimet mund të hetoheshin ndonjëherë; dhe
- b) gjendjen e dosjeve të trashëguara nga UNMIK-u. Në atë drejtim, Misioni tregon për natyrën joadekuate dhe jo të plotë të të dhënave - rreth 800,000 faqe - që ishin siguruar nga UNMIK-u, i cili kërkoi që Misioni të investonte shumë kohë dhe burime në rishikimin dhe organizimin e tyre.

31. Mbi atë bazë, Misioni fton Panelin të sigurojë që vlerësimi i tij për atë që mund të ishte bërë në ato rrethana duhet të ishte realist dhe proporcional. Në veçanti, Misioni shpjegon se efekti i kombinuar i një numri të madh të lëndëve dhe burimeve të kufizuara bëri që Misioni t'i jepte përparësi 1,200 dosjeve të lëndëve të etiketuara 'krime lufte' nga UNMIK-u - mbi 'dosjet e personave të zhdukur' - dhe, brenda kategorisë së mëparshme, raste që u shfaqën 'më premtuese për sa i përket rezultateve të hetimit'.

32. Lidhur me detyrën e tij për të mbajtur të informuar të afërmit e të zhdukurve, Misioni tha si vijon:

'Misioni pranon që, me synimin për të menaxhuar pritjet në mënyrë më adekuate dhe për të qenë më transparent, ai duhet të kishte bërë më shumë për të mbajtur të informuar të afërmit dhe publikun e gjerë në lidhje me zbatimin e mandatit të tij, si dhe kufizimet e tij. Sidoqoftë, në rastin aktual dhe duke marrë parasysh pengesat themelore të paraqitura, Misioni nuk beson se të drejtat e ankuesit ishin shkelur'.

33. Lidhur me ndryshimin në mandatin e Misionit dhe efektin e tij mbi këtë rast, Misioni tregoi se ai mban një kapacitet ekzekutiv për të mbështetur Institutin e Mjekësisë Ligjore të Kosovës në kryerjen e aktiviteteve të tilla si vlerësimet e vendit, zhvarrosjet dhe gërmimet dhe mbetet në dispozicion nëse dalin në dritë informacion i ri i besueshëm.

34. Misioni gjithashtu jep një përshkrim të përgjithshëm të aktiviteteve të tij monitoruese, d.m.th., observimi dhe raportimi i tij i rasteve që trajtohen nga autoritetet vendore, megjithëse nuk sugjeron që aktualisht po monitoron lëndët në lidhje me ankesën aktuale.

V. SHYRTIMET

Rëndësia e të drejtave dhe interesave të mbrojtura

35. Si çështje paraprake, Paneli dëshiron të nënvizojë faktin se të drejtat në fjalë në rastet e zhdukjes me forcë janë ndër më të rëndësishmet nga të gjitha të drejtat themelore të njeriut. Në veçanti, raste të tilla shpesh përfshijnë çështje që kanë të bëjnë me të drejtën për jetë, të drejtën për të mos iu nënshtruar trajtimit mizor dhe çnjerëzor, të drejtën për të vërtetën, të drejtën për të respektuar jetën familjare dhe të drejtën për të pasur qasje në drejtësi.
36. Natyra dhe shtrirja e masave që do të miratohen nga autoritetet kompetente për të garantuar mbrojtjen efektive të këtyre të drejtave duhet të jenë në përpjesëtim dhe të maten përkundër rëndësisë që u kushtohet këtyre të drejtave dhe interesave themelorë që ata kërkojnë të mbrojnë. Shih, për shembull, *Milijana Avramović kundër EULEX-it*, Lënda nr. 2016-17, Vendimi dhe Gjetjet e datës 4 qershorit 2020, par. 35.

Kryerja e një vlerësimi realist të veprimeve të Misionit

37. Të drejtat dhe interesat e mbrojtura nga nenet 2 dhe 3 të Konventës duhet të sigurohen dhe garantohen në të gjitha rastet. Sidoqoftë, rrethanat në të cilat duhet të bëhet kjo mund të ndikojnë në atë që mund të bëhet në praktikë dhe, për këtë arsye, në atë që mund të pritët nga autoritetet. Si rezultat, ndërsa rreziqet vështirë se mund të ishin më të larta për viktimat, një vlerësim i sjelljes së autoriteteve kur kërkojnë të mbrojnë të drejtat e tyre duhet të japë llogari për rrethanat përkatëse në të cilat gjendeshin ato autoritete në atë kohë. Sidoqoftë, vështirësitë që lidhen me rrethanat e mbizotëruara në atë kohë - për shembull, një situatë konflikti ose një situatë pas konfliktit - duhet të dallohen qartë nga çështjet që kanë të bëjnë me burimet e disponueshme. Ndërsa autoritetet nuk janë përgjegjës për të parët dhe duhet të bëjnë sa më mirë që munden në rrethanat në atë kohë, të dytët nuk japin asnjë justifikim të vlefshëm për t'u tërhequr nga detyrimet ndaj të drejtave të njeriut. Në vend të kësaj, është përgjegjësi e atyre autoriteteve të sigurojnë që burimet të jenë të organizuara, shpërndara dhe përdorura në mënyrë të tillë që të sigurojnë që detyrimet e saj për të drejtat e njeriut të mbahen dhe të drejtat përkatëse të mbesin efektive. Shih, për shembull, *Milijana Avramović kundër EULEX-it*, Lënda nr. 2016-17, Vendimi dhe Gjetjet e datës 4 qershor 2020, par. 37.
38. Prandaj, pritjet e vendosura mbi aftësinë e EULEX-it për të hetuar dhe zgjidhur çështje komplekse penale duhet të jenë realiste dhe të mos vendosin mbi misionin një barrë joproporcionale që mandati dhe burimet e tij nuk janë në gjendje të përmbushin. Shihni, përgjithësisht, *U.F. kundër EULEX-it*, 2016-12, Vendimi dhe Gjetjet, 12 shkurt 2020, paragrafi 60; *L.O. kundër EULEX-it*, 2014-32, 11 nëntor 2015, par. 43-45; *A, B, C, D kundër EULEX-it*, 2012-09 deri 2012-12, 20 qershor 2013, paragrafi 50; *K to T kundër EULEX-it*, 2013-05 deri 2013-14, 21 prill 2015, par. 53; *Sadiku-Syla kundër EULEX-it*, 2014-34, Vendimi mbi Pranueshmërinë, 29 shtator 2015, paragrafët 35-37; *D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it*, 2014-11 deri 2014-17, Vendimi mbi Pranueshmërinë, 30 shtator 2015, paragrafët. 72-74; shih gjithashtu Vendimin e Panelit Këshillëdhënës për të Drejtat e Njeriut të UNMIK-it (PKDNj) në rastet nr. 248/09, 250/09 dhe 251/09, 25 prill 2013, par. 35 dhe paragrafët 70-71.

39. Në veçanti, Misioni i EULEX-it nuk është shtet dhe aftësia e tij për të garantuar mbrojtjen efektive të të drejtave të njeriut nuk mund të krahasohet në të gjitha aspektet përkatëse me atë që mund të pritet nga një shtet (shih, p.sh., vendimi i Panelit në A, B, C, D kundër EULEX-it, 2012-09 deri 2012-12, 20 qershor 2013, paragrafi 50; K deri T kundër EULEX, cituar më lart, paragrafi 53; shih gjithashtu Vendimin PKDNj në lëndët nr. 248/09, 250/09 dhe 251/09, 25 prill 2013, par. 35; SH kundër EULEX-it, Vendimi dhe Gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 49).
40. Në këtë drejtim, Paneli vëren se detyra e dhënë Misionit ishte në shumë aspekte diskurajuese. Numri i rasteve që pritej të hetonte ishte jashtëzakonisht i madh dhe ato raste ishin komplekse. Burimet e vendosura në dispozicion ishin në shumë aspekte të pamjaftueshme dhe joadekuate. Për më tepër, të dhënat e transmetuara në Mision nga UNMIK-u ishin në një gjendje të dobët dhe kërkuan që Misioni të shpenzonte një sasi të konsiderueshme të kohës dhe burimeve thjesht duke u përpjekur t'u jepte kuptim atyre.
41. Situata pas konfliktit në të cilën Misioni duhej të vepronte gjithashtu e komplikoi punën e saj edhe më tej. Shikoni p.sh. *L.O. kundër EULEX-it*, 2014-32, 11 nëntor 2015, par. 44 dhe referencat e cituara në të.
42. Paneli vëren se nenet 2 dhe 3 të Konventës janë të drejta të pazëvendësueshme sipas nenit 15(2) të konventës. Sidoqoftë, siç u përmend më lart, ajo që autoritetet mund të pritet të bëjnë në një rast të caktuar për të siguruar këto të drejta do të varet pjesërisht nga rrethanat mbizotëruese në atë kohë. Në rastin aktual, Paneli është veçanërisht i vetëdijshëm për faktin se rrethanat pas konfliktit kishin pasoja praktike për aftësinë e Misionit për të kryer veprime në lidhje me ata që ngritin shqetëime nga mandati i tij ekzekutiv. Prandaj, këto elemente dhe konsiderata janë marrë parasysh nga Paneli për të përcaktuar se çfarë, në ato rrethana, legjitimisht mund të pritet nga Misioni në lidhje me lëndën në fjalë. Shih, për shembull, *Milijana Avramović kundër EULEX-it*, Lënda nr. 2016-17, Vendimi dhe Gjetjet e datës 4 qershorit 2020, par. 41
43. Së pari duhet të adresohen disa çështje paraprake. Duhet të theksohet se garancia e përfshirë në nenin 2 të Konventës Evropiane është një prej *mjeteve* e jo *rezultat*. Vërtetë është e saktë pasi një shtet ose autoritetet përkatëse nuk mund të fajësohen për dështimin në mbrojtjen e të drejtave të një individi nëse ata kanë bërë maksimumin e tyre dhe atë që ligji priste për t'i mbrojtur ato të drejta. Sidoqoftë, si një detyrim i mjeteve, ligji pret që mjetet e investuara për të garantuar mbrojtjen efektive të të drejtave themelore janë në përpjesëtim me rëndësinë e së drejtës në fjalë dhe peshën e shkeljes së mundshme që autoritetet kërkojnë të parandalojnë dhe të korrigjojnë. Në veçanti, në lëndën Mustafa Tunç dhe Fecire Tunç kundër Turqisë (Aplikacioni nr. 24014/05, Aktgjykim, 14 prill 2015 (Dhoma e Madhe), paragrafët 172, të cilat Paneli miratoi në lëndën nr. 2016-12 (par. 63), Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut tha këtë:
172. Në mënyrë që të jetë 'efektiv' pasi kjo shprehje duhet të kuptohet në kontekstin e nenit 2 të Konventës, një hetim së pari duhet të jetë adekuat (shih Ramsahai dhe të tjerët kundër Hollandës [GC], nr. [52391/99](#), § 324, KEDNj 2007 II). Kjo do të thotë, ai duhet të jetë i aftë të çojë në vërtetimin e fakteve dhe, kur është e përshtatshme, në identifikimin dhe dënimin e atyre që janë përgjegjës.
173. Detyrimi për të kryer një hetim efektiv është një detyrim jo si rezultat por si mjet: autoritetet duhet të marrin masat e arsyeshme në dispozicion të tyre për të siguruar prova në lidhje me incidentin në fjalë (shih Jaloud kundër Hollandës [GC], nr. [47708/08](#), § 186, KEDNj 2014; dhe Nachova dhe të tjerët kundër Bullgarisë [GC], nr. [43577/98](#) dhe [43579/98](#), § 160, ECHR 2005 VII).

174. Në çdo rast, autoritetet duhet të ndërmarrin çfarëdo hapi të arsyeshëm që mundën për të siguruar provat në lidhje me incidentin, duke përfshirë, ndër të tjera, dëshminë e dëshmitarit okular, provat mjeko-ligjore dhe, kur është e përshtatshme, një autopsi e cila siguron një regjistër të plotë dhe të saktë të lëndimit, një analizë objektive e gjetjeve klinike, përfshirë edhe shkakun e vdekjes. Çdo mangësi në hetim që minon aftësinë e tij për të vërtetuar shkakun e vdekjes ose personi përgjegjës do të rrezikojë të ketë mangësi të këtij standardi (shih *Giuliani dhe Gaggio kundër Italisë* [GC], nr. 23458/02, § 301, KEDNj 2011).

Paneli do të marrë parasysh këto konsiderata në vlerësimin e përgjigjes së Misionit në këtë rast.

44. Paneli gjithashtu do të shqyrtojë nëse kishte pengesa konkrete dhe reale që mund të kishin minuar mundësinë që EULEX-i të kryejë ndonjë hetim të shpejtë dhe efektiv të një lëndeje. Një vlerësim i tillë nuk ka për qëllim të justifikojë mangësitë operationale që nuk lidhen me sfida konkrete dhe të demonstrueshme, as të ndikojë në standardin ndaj të cilit duhet të mbahet Misioni në dritën e detyrimeve të tij ndaj të drejtave të njeriut. Shih L.O. kundër EULEX-it, 2014-32, 11 nëntor 2015, par. 44; D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S., I.R. kundër EULEX-it, 2014-11 deri 2014-17, 30 shtator 2015, par. 73-74; dhe K, L, M, N, O, P, Q, R, S & T (K në T) kundër EULEX-it, 2013-05 deri 2013-14, 21 prill 2015, par. 54; Sadiku-Syla kundër EULEX-it, 2014-34, 19 tetor 2016, par. 31; D.W., E.V., F.U., G.T., Zlata Veselinović, H.S. dhe I.R. kundër EULEX, 2014-11 deri 2014-17, 19 tetor 2016, par 57.

Mungesa e hetimit

45. Në rastin aktual, nuk kishte asnjë hetim nga Misioni, intervistë me dëshmitarë ose të afërm, kërkesë për dokumentacion, kontakte me UNMIK-un, ose ndonjë përpjekje të dukshme për të marrë dokumente që UNMIK-u kishte mbledhur në lidhje me të. Siç u diskutua më poshtë, gjithashtu nuk kishte asnjë kontakt, ose përpjekje për kontakt me familjarët e të zhdukurve.
46. Arsyeja e paraqitur nga Misioni për këtë situatë është se ajo u jepte përparësi rasteve që ishin klasifikuar nga UNMIK-u si "krime lufte" sesa "rasteve të personave të zhdukur", dhe që ishin "më premtuese për sa i përket rezultatit hetimor". Paneli e gjen argumentin e tillë si problematik për një numër arsyesh.
47. Së pari, e drejta për një hetim në rastet e zhdukjes me forcë nuk është opsionale dhe është e pazëvendësueshme. Misioni nuk ka arritur të shpjegojë pse ankuesi do të kishte më pak të drejtë për të vërtetën dhe drejtësinë se çdo viktimë tjetër në të njëjtën pozitë.
48. Së dyti, konsideratat praktike (të tilla si numri i rasteve dhe burimet e kufizuara të autoriteteve në fjalë) mund të nënkuptojnë që disa rasteve mund të jepet përparësi mbi të tjerat. Sidoqoftë, kjo në asnjë rrethanë nuk e largon thelbin e asaj të drejte, d.m.th., nuk e heq ose zvogëlon detyrimin për të kryer një hetim efektiv. Edhe atje ku mbizotërojnë rrethana të vështira, autoriteti duhet të ndërmarrë të gjithë hapat e arsyeshëm në rrethana. Prandaj, kur një hetim përkohësisht nuk është i mundur, duhet të vendosen mjete dhe mekanizma të tjerë për të siguruar që të drejtat në fjalë që të ruhen mjaftueshëm dhe të garantohet thelbi i tyre. Në veçanti, duhet të ndërmerren hapa për të siguruar që mundësia e një hetimi, edhe nëse vonohet, të ruhet dhe të mos humbasë për shkak të vonësive në fillimin zyrtar të tij.
49. Së treti, nga këndvështrimi i të drejtave të njeriut, karakterizimi ligjor i një akti të 'zhdukjes' si një krim lufte ose si diçka tjetër (p.sh., një krim kundër njerëzimit; një vrasje; një shkelje

e të drejtave të njeriut; një krimi i motivuar etnikisht; ose një veprim i ndalimit të paligjshëm) nuk ka rëndësi materiale për autoritetet që përmbushin detyrimet e tyre ligjore. Për më tepër, nuk ka ndonjë arsye të dukshme pse kjo çështje e veçantë mund të mos ketë arritur të përbëhet si krim lufte (nën një larmi etiketash të mundshme ligjore) dhe Misioni nuk sugjeroi që ajo të mos ishte kualifikuar nën atë ombrellë.

50. Në këtë rast, Paneli thekson që mungesa e hetimit ishte shtuar nga mungesa e komunikimit me të afërmit e të zhdukurve. Për më tepër, Misioni nuk ndërmori asnjë hap për të siguruar mjete alternative për të lehtësuar efektin e kësaj mungese hetimi mbi të drejtat e atyre që ishin kishin pasur ankesë. 'Prioritizimi' i pretenduar i tij, për këtë arsye rezultoi në një mungesë të plotë të hetimit, korrigjimit dhe të vërtetës sa i përket kësaj lënde.
51. Paneli vëren në këtë kontekst se situata pas konfliktit në të cilën Misioni duhej të vepronte nuk e pengoi në asnjë mënyrë Misionin të ndërmarrë këto veprime. As mungesa e burimeve nuk siguron ndonjë shpjegim të vlefshëm për dështimin e tij për ta trajtuar këtë lëndë.
52. Në këtë drejtim, Paneli do të shtojë sa vijon. Së pari, ishte përgjegjësia e Misionit të siguronte që ajo të organizohej dhe të shpërndante burimet e saj në një mënyrë në përputhje me detyrimet e saj ndaj të drejtave të njeriut. Si mision i 'sundimit të ligjit', është e qartë se përgjegjësitë që kanë të bëjnë me sundimin e ligjit duhet të kishin qenë përparësitë institucionale dhe operacionale.
53. Së dyti, aty ku është e nevojshme për t'u dhënë përparësi veprimtarive të caktuara mbi të tjerat, duhet të sigurohej, së paku, se (a) ishte hartuar dhe publikuar një strategji dhe politikë e qartë për këtë qëllim (dhe e cila, nga dijenia e Panelit, nuk ka ekzistuar kurrë)) dhe se (b) prioritizimi nuk rezultoi në braktisjen e detyrimeve të tij ndaj të drejtave të njeriut, veçanërisht në lidhje me ato të drejta që kanë karakter absolut.
54. Duke marrë parasysh që Misioni po zëvendësonte autoritetet vendore në shumë prej përgjegjësive të tij ekzekutive, duhej që Misioni të siguronte që kjo të bëhej në përputhje të plotë me ato përgjegjësi të të drejtave të njeriut që ishin të lidhura me atë rol. Mungesa e burimeve nuk jep arsyetim për dështimin për ta bërë këtë. Nëse ndonjë gjë, kjo do të duhej të kërkonte që Misioni të kërkonte burime që i mungonin ose, kur kjo ishte refuzuar, të publikonte qartë dhe sinjerisht faktin se ai do të ishte në gjendje të merrej vetëm me një grup të ngushtë të përgjegjësive ekzekutive. Kjo nuk duket se ka ndodhur.
55. Transparenca, megjithëse nuk është zëvendësim për kryerjen e një hetimi efektiv ose përmbushjen e detyrimeve të tjera ndaj të drejtave të njeriut, është një element i rëndësishëm i përgjegjësisë dhe viktimat e shkeljeve të të drejtave të njeriut kishin të drejtë të dinin se çfarë ishte në të vërtetë në gjendje të bënte Misioni për të korrigjuar shkeljet e të drejtave të tyre. Ndonëse sfiduese, situata pas konfliktit në të cilën Misioni duhej të vepronte nuk ofron një shpjegim të kënaqshëm për dështimin në shkallë të gjerë për t'u marrë me çështjen aktuale dhe raste të tjera të këtij lloji. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut e ka bërë të qartë - megjithëse në lidhje me shtetet - që detyrimet ndaj të drejtave të njeriut duhet të përmbushen gjithashtu në kontekstin e një konflikti të armatosur në vazhdim, duke përfshirë kërkesat procedurale sipas nenit 2 të Konventës për të kryer një hetimi (shih, p.sh., *Al-Skeini kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aplikacioni nr. 55721/07, Aktgjykim, 7 korrik 2011; *Jaloud kundër Holandës*, Aplikacioni nr. 47708/08, Gjykim, 20 nëntor 2014).
56. Dështimi i Misionit për të trajtuar raste të tilla mund të jetë bërë më i vështirë nga burimet e tij të kufizuara dhe nga sfidat e paraqitura nga situata pas konfliktit në të cilën ai duhej të vepronte. Por një dështim për të planifikuar si duhet dhe për të zhvilluar strategji të

hollësishme dhe transparente për t'u marrë me ato raste është të paktën nëse jo më domethënës në shpjegimin e faktit se lënda në fjalë nuk ishte hetuar dhe se nuk ishte bërë asnjë përpjekje për t'i kontaktuar viktimat.

57. Së treti, përderisa prioritizimi i rasteve mund të jetë i arsyeshëm kur rastet që kërkojnë veprimet e autoriteteve janë në numë të madh për nga kapaciteti i tij, vendimi për t'i dhënë përparësi duhet të përmbushë disa kërkesa themelore. Së pari, nuk duhet të diskriminojë në baza të palejueshme të ndaluara nga ligji për të drejtat e njeriut. Shih, përgjithësisht, nenin 14 të KEDNj-së; nenet 2 dhe 7 Deklarata Universale e të Drejtave të Njeriut; nenet 4(1) dhe 26 të ICCPR; dhe neni 1 (3) i Kartës së KB-së. Së dyti, siç u bë e qartë nga GJEDNj-ja (cituar sipër në paragrafin 30), detyrimi për të kryer një hetim efektiv kërkon që autoritetet të marrin masat e arsyeshme në dispozicion të tyre për të siguruar prova në lidhje me incidentin në fjalë (*Mustafa Tunç dhe Fecire Tunç kundër Turqisë*, Aplikacioni nr. 24014/05, Aktgjykim, 14 prill 2015 (Dhoma e Madhe), paragrafët 173-174). Në këtë rast, Misioni nuk u përfshi në ndonjë proces të mbledhjes së provave. Në fakt, ai madje nuk i kërkoi UNMIK-ut ose autoriteteve të tjera dosjet e fjetura që ata kishin ose mund të kishin në posedim të tyre. Kjo e çon Panelin në një shqetësim të katërt lidhur me rrjedhën e veprimit të ndërmarrë nga Misioni. Për më tepër, një përparësi e tillë në asnjë rrethanë nuk mund të rezultojë në një braktisje të plotë të standardeve përkatëse të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, në veçanti kur, si në rastin aktual, të drejtat në fjalë kanë karakter absolut.
58. Për të shpjeguar dështimin e tij për të hetuar këtë rast, Misioni sugjeron që ai duhej të jepte përparësi rasteve që dukeshin 'më premtuese për sa i përket rezultateve të hetimit'. Në mungesë të ndonjë hetimi paraprak të kësaj lënde, Paneli nuk është i bindur se një vlerësim i tillë mund të ishte kryer në mënyrë të drejtë, në një mënyrë të informuar dhe në një mënyrë që garantonte mbrojtjen efektive të të drejtave të atyre që janë ankuar. Paneli nuk është i bindur se Misioni mund të ketë qenë në gjendje të bëjë një vlerësim të tillë pa kërkuar dosjen e UNMIK-ut dhe pa kryer ndonjë intervistë ose kontaktuar me ata që janë më afër të zhdukurve. Prandaj, Paneli nuk është i kënaqur që vlerësimi i përparësisë së Misionit ishte bazuar në një bazë të mjaftueshme dhe të besueshme për të siguruar dhe garantuar të drejtat e atyre që janë që janë ankuar.
59. Për më tepër, përpara se të merrej vendimi i mësipërme që do të kishte pasoja të tilla domethënëse ndaj të drejtave të ankuesit, Misioni do të pritej që të kërkonte ndihmën dhe bashkëpunimin e autoriteteve të tjera nëse dhe kur këta të fundit mund të kishin në posedim informacionin dhe/ose burimet që kanë lidhje me përpjekjet e të parit për të kryer një hetim efektiv. Në përgjithësi, *U.F. kundër EULEX-it*, 2016-12, Vendimi dhe Gjetjet, 12 shkurt 2020, par. 64, duke iu referuar: lëndës *Güzelyurtlu dhe të tjerët k. Qipros dhe Turqisë*, Aplikacioni nr. 36925/07, Aktgjykim, 29 janar 2019, paragrafët 229 dhe 232-233. Misioni nuk arriti t'i kontaktojë ata me informacione (potenciale) në lidhje me këtë rast dhe nuk ka dhënë asnjë shpjegim për atë dështim.
60. Në dritën e mësipërme, edhe nëse Misioni do të ishte autorizuar t'u jepte përparësi rasteve të caktuara të kësaj natyre (të paktën përkohësisht), ai nuk veproi në këtë rast në një mënyrë që të ishte në përputhje me ruajtjen efektive të të drejtave të ankuesit. Dështimi i saj i plotë për të hetuar këtë çështje dhe për të ndërmarrë edhe hapat më themelorë për të pasur në zotërim të gjithë informacionin në dispozicion para se të vendoste për të mos hetuar atë përbën një shkelje serioze të detyrimeve të saj të të drejtave të njeriut sipas nenit 2 (gjymtyrë procedurale) dhe 3 të Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut. Ajo zbulon mungesën e zellit dhe të drejtësisë në ushtrimin e një elementi kritik të mandatit të saj.

Mos informimi i të afërmeve të ngushtë për të zhdukurit

61. Ligji ndërkombëtar i të drejtave të njeriut kërkon që në një rast siç është ai i tanishmi, të afërmit e të zhdukurve duhet të mbahen të informuar sa duhet për rrjedhën e hetimit të çështjes dhe rrjedhën e procedurave. Në përgjithësi shih *U.F. kundër EULEX-it*, 2016-12, Vendimi dhe Gjetjet, 12 shkurt 2020, paragrafi 97; *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe Gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 66; *Desanka dhe Zoran Stanisić kundër EULEX-it*, 2012-22, 11 nëntor 2015, par. 66; *L.O. kundër EULEX-it*, 2014-32, 11 nëntor 2015, paragrafët. 60-61, 72-73; PShDNj-së, Shënim i praktikës gjyqësore mbi detyrën për të hetuar pretendimet e shkeljeve të të drejtave, fq. 28-30; shih gjithashtu *Ahmet Özkan dhe të tjerët kundër Turqisë*, Aplikacioni nr. 21689/93, Aktgjykimi i GJEDNj-së i datës 6 prillit 2004, paragrafët. 311-314, *Isayeva k. Rusisë*, Aplikacioni nr. 57950/00, Aktgjykimi i GJEDNj-së i datës 24 shkurtit 2005, paragrafët. 211-214; *Al-Skeini dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aplikacioni nr. 55721/07, Aktgjykimi i GJEDNj-së i datës 7 korrik 2011, par. 167.
62. Kjo kërkesë ka për qëllim të sigurojë që të afërmit mund të kontribuojnë në mënyrë domethënëse dhe të marrin pjesë në proces. Ai gjithashtu kërkon të zvogëlojë sforcimin dhe dhimbjen për të mos ditur se çfarë i ndodhi të dashurit të tyre. Shih gjithashtu *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe Gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 66; *U.F. kundër EULEX-it*, 2016-12, Vendimi dhe Gjetjet, 12 shkurt 2020, par. 96.
63. Detyrimi për t'i mbajtur të informuar viktimat në hapin e përpjekjeve hetimore është veçanërisht i rëndësishëm në një rast që përfshin akte të zhdukjes me forcë pasi të afërmit e mbijetuar mund të mos kenë asnjë burim tjetër informacioni në lidhje me fatin e të afërmit (tyre) të tyre, dhe ata do të vazhdojnë të jetojnë në shpresoj që fati i të afërmit (tyre) të tyre një ditë do të sqarohet. Si rezultat, të afërmit e ngushtë të viktimave të zhdukura vuajnë emocionalisht nga mungesa e informacionit në lidhje me fatin e të dashurit të tyre. Shih *U.F. kundër EULEX*, 2016-12, Vendimi dhe Gjetjet, 12 shkurt 2020, paragrafi 98; *Zufe Miladinović kundër EULEX-it*, 2017-02, 19 qershor 2019, par. 87; *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe Gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 78. Një kërkesë e tillë është një element i domosdoshëm i mbrojtjes së të drejtave të viktimave në hetimin e një çështjeje të tillë. Shih p.sh., *U.F. kundër EULEX*, 2016-12, Vendimi dhe Gjetjet, 12 shkurt 2020, paragrafi 98; *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe Gjetjet, çështja nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 77; *Desanka dhe Zoran Stanisić kundër EULEX-it*, 2012-22, 11 nëntor 2015, par. 66, duke iu referuar *L.O. kundër EULEX*, 2014-32, 11 nëntor 2015, paragrafët. 60-61, 72-74; *Zufe Miladinović kundër EULEX-it*, 2017-02, 19 qershor 2019, par. 86; shih gjithashtu *Ahmet Özkan dhe të tjerët kundër Turqisë*, ë21689/93, Aktgjykimi i GJEDNj-së i datës 6 prillit 2004, paragrafët. 311-314, *Isayeva k. Rusisë*, Kërkesa nr. 57950/00, Aktgjykimi i GJEDNj i 24 shkurtit 2005, paragrafët. 211-214; *Al-Skeini dhe të tjerët kundër Mbretërisë së Bashkuar*, ë55721/07, Aktgjykimi i GJEDNj-së i 7 korrikut 2011, par. 167.
64. Autoritetet kompetente nuk do të lejohen lehtësisht të shpërfillin ose injorojnë këtë detyrim. Shih *S.H. kundër EULEX-it*, Vendimi dhe Gjetjet, lënda nr. 2016-28, 11 shtator 2019, par. 67; *U.F. kundër EULEX-it*, 2016-12, Vendimi dhe Gjetjet, 12 shkurt 2020, paragrafi 98.
65. Paneli gjithashtu vëren se e drejta për të vërtetën në lidhje me shkeljet e të drejtave të njeriut nuk është vetëm një e drejtë individuale. Poashtu ajo është një e drejtë kolektive që shërben për të ruajtur kujtesën në nivelin e shoqërisë dhe duke vepruar si një mbrojtje kundër përsëritjes së shkeljeve. Shih *Komentin e Përgjithshëm mbi të Drejtën për të Vërtetën në lidhje me Zhdukjen me Forcë*, Raportin e Grupit Punues për Zhdukjet e Detyruara ose të Vullnetshme (2010), Dokumenti A/HRC/16/48, Preambulë. Në kontekstin pas konfliktit të Kosovës, hetimet e zhdukjeve me forcë kontribuan - dhe

vazhdojnë të kontribuojnë - në promovimin e së vërtetës, në kujtesën kolektive të shkeljeve të tilla të drejtave të njeriut dhe në sigurimin e mos-përsëritjes së tyre. Shih, për shembull, Dragiša Kostić kundër EULEX-it, Lënda nr. 2016-10, Vendimi dhe Gjetjet i datës 13 shkurt 2020, par. 74 dhe referencat atje; Milijana Avramović kundër EULEX-it, Lënda nr. 2016-17, Vendimi dhe Gjetjet e datës 4 qershorit 2020, par. 59.

66. I pyetur nga Paneli pse Misioni nuk kërkoi të kontaktojë me familjarët e të zhdukurve, Misioni u përgjigj se nuk mund të kishte kontaktuar me të afërmit në të gjitha rreth 5,000 'raste të personave të zhdukur', dhe se, për këtë arsye, ai nuk kërkoi të kontaktonte të afërmit në këtë rast.
67. Paneli e konsideron këtë shpjegim si të pakënaqshëm. Edhe nëse vendimi i Misionit për të mos hetuar kishte qenë i pranueshëm, ai nuk e kualifikonte ose kufizonte detyrimin e tij për të mbajtur të informuar të afërmit pasi ato pasqyrojnë dy detyrime të ndara që burojnë nga e njëjta e drejtë. Në vend të kësaj, mungesa e informacionit nga ana e Misionit mund të ketë vazhduar të ushqejë shpresën e familjes se çështja përfundimisht do të vihej para drejtësisë, siç kishin të drejtë të prisnin.
68. Detyrimi i përshkruar më sipër nuk është opcional dhe është i rëndësishëm. Përpjekjet e vendosura nga Misioni për ta përmbushur atë - ose, më saktë, mungesa e tij - nuk pasqyrojnë rëndësinë e interesave që ishin në rrezik. Dështimi i Misionit do të kishte kontribuar më tej për ta lënë ankuesin në një gjendje pasigurie, duke i shkaktuar atij shqetësime emocionale shtesë.
69. Bazuar në sa më sipër, Paneli konstaton se Misioni ka dështuar të përmbushë detyrimin e tij për të informuar ankuesin ashtu siç ishte kërkuar dhe, duke vepruar kështu, kishte shkelur të drejtat e tij themelore siç garantohen në nenet 2 (pjesa procedurale) dhe 3 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut.
70. Në dritën e gjetjeve të Panelit në lidhje me nenet 2 dhe 3 të Konventës, nuk është rreptësisht e nevojshme që Paneli të bëjë gjetje specifike në lidhje me të drejtat e garantuara sipas nenit 8 të Konventës. Sidoqoftë, Paneli dëshiron të nxjerrë në pah faktin se një nga pasojat më serioze të shkeljes së të drejtave të ankuesit kanë të bëjnë me jetën e tij familjare. Për dy dekada tani, ai jeton pa babanë e tij, dhe pa mbështetjen e tij emocionale dhe financiare, të shoqëruara nga pasiguria e dhimbshme e fatit të tij. E drejta e tij për respekt për jetën e tij familjare është prekur qartë nga situata.

E drejta për një mjet juridik

71. Kjo lëndë pasqyron një realitet shumë më të gjerë dhe një problem më të madh institucional, të cilin Paneli e ka vërejtur në këtë dhe në rastet e tjera që kanë dalë para tij.
72. Regjistrimi i këtyre procedurave sugjeron që shumë dhe ndoshta shumica e rasteve të zhdukjes me forcë që datojnë që nga konflikti i Kosovës dhe pasojat e tij janë lënë të pa hetuara dhe të pazgjithura. Ata së pari ranë nën përgjegjësinë e Kombeve të Bashkuara; Pastaj EULEX-it Kosovë; Dhe tani tek autoritetet vendore të Kosovës. Pavarësisht përfshirjes së autoriteteve të shumta gjatë dy dekadave, shumica e atyre rasteve kanë mbetur të pa hetuara ose në gjendje të paqartë. Si rezultat, viktimat kanë pasur pak drejtësi dhe të vërtetë, dhe pak shikueshmëri mbi atë që po bëhej nga ata me përgjegjësi për të vepruar për të mbrojtur dhe garantuar të drejtat e tyre.
73. Në secilën fazë, viktimat do të kishin të drejtë të besonin, të prisnin dhe të shpresonin që autoritetet e reja do të bënin më mirë se ai i mëparshmi. Ata duhet të jenë zhgënjyer shumë që shpresat e tyre nuk u realizuan. Shumica e rasteve të zhdukjes me forcë

mbeten, në mënyrë të pabesueshme dhe të pafalshme, të pa hetuara pas dy dekadash. Tekstualisht qindra prej tyre kaluan nëpër duart dhe përgjegjësinë e EULEX-it Kosovë pa u hetuar.

74. Kur u pyet për gjendjen aktuale të disa prej rasteve - përfshirë edhe rastin aktual - që kaluan 10 vjet nën përgjegjësinë e EULEX-it, Misioni tani u referohet autoriteteve të Kosovës si ekskluzivisht përgjegjës për to. Megjithatë, të drejtat e njeriut nuk janë një kovë që autoritetet duhet të kalojnë nga njëra tek tjetra. EULEX-i Kosovë kishte, për një dekadë, përgjegjësinë për të hetuar këto raste - përfshirë edhe këtë - dhe nuk arriti ta bëjë këtë. Dorëzimi i funksioneve dhe përgjegjësi të tij ekzekutive në sektorin e drejtësisë penale tek autoritetet vendore nuk lë mënjanë përgjegjësinë e tij për shkeljet e të drejtave të njeriut që ka kryer në të kaluarën. Tani duhet të rregullojë pasojat e veprimeve dhe vendimeve të veta.
75. Në këtë dritë, Paneli konsideron se Misioni ka shkelur dhe po shkel aktualisht një të drejtë tjetër të ankuesit, domethënë, të drejtën e tij për një mjet efektiv juridik siç garantohet, ndër të tjera, nga neni 13 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, neni 8 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut dhe Nenit 2 (3) të Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike. Shih gjithashtu *Kudla k. Polonisë*, Kërkesa nr. 30120/96, Aktgjykim, 26 tetor 2000, në veçanti, par. 152.
76. Paneli fton shefin e Misionit të marrë në konsideratë të kujdesshme pasojat e këtyre gjetjeve dhe cilat masa duhet të vendosen për të siguruar një mjet efektiv juridik për shkeljen e të drejtave të ankuesit. Fakti që të drejtat e ankuesit janë shkelur për dy dekada, njëra prej të cilave nën përgjegjësinë e Misionit EULEX, duhet të justifikojë që hapat e ndërmarrë duhet të jenë të tillë që të pasqyrojnë peshën dhe kohëzgjatjen e këtyre shkeljeve, si dhe nevojën për efektivitet në rregullimin e atyre. Në përgjithësi shih *Kisha e Jezu Krishtit e Shenjtorëve të Ditëve të Mëvonshme kundër Mbretërisë së Bashkuar*, Aplikacioni nr. 7552/09, Aktgjykimi i GjEDNj-së, 4 mars 2014, në veçanti, paragrafi. 41; *Husayn (Abu Zubaydah) kundër Polonisë*, Kërkesa nr. 7511/13, Aktgjykimi i GjEDNj, 24 korrik 2014, para 540; *Kaya kundër Turqisë*, Kërkesa nr. 158/1996/777/978, Aktgjykimi i GjEDNj, 19 shkurt 1998, paragrafi. 106; *Mahmut Kaya kundër Turqisë*, Aplikacioni nr. 22535/93, Aktgjykimii i GjEDNj-së 28 mars 2000, në veçanti, paragrafi. 124.

Të ndryshme

77. Në një moment në gjysmën e dytë të vitit 2018, dosja e lëndës që i përkiste z. Brakus iu dorëzua institucioneve kompetente të Kosovës. Misioni vëren se ai mban një kapacitet ekzekutiv për të mbështetur Institutin e Mjekësisë Ligjore të Kosovës dhe se është i gatshëm të mbështesë institucionet e Kosovës në çdo përpjekje për të gjetur z. Brakus dhe çdo person tjetër të zhdukur. Për më tepër, Misioni thekson se, megjithëse nuk mund të këshillojë institucionet e Kosovës për raste individuale, ai ofron rekomandime që adresojnë çështje sistematike dhe po mbështet administrimin e hetimeve penale, si dhe sigurimin e trajnimeve përkatëse për Policinë e Kosovës.
78. Nuk ka asnjë tregues të një hetimi që ka filluar nga autoritetet vendore për lëndën në fjalë. Nuk ka asnjë pengesë që Misioni të bëjë kërkime në lidhje me këtë dhe raste të tjera të ngjashme me autoritetet vendore. As Misioni nuk është penguar në asnjë mënyrë të hetojë në lidhje me 'fatin' e rasteve që u kërkuan dhe nuk arriti të hetojë për të siguruar që ai tani të sigurojë një mjet efektiv juridik për shkeljet e të drejtave që rezultuan.
79. Prandaj, Paneli fton Misionin të përdorë të gjitha fuqitë dhe kompetencat e tij për të siguruar që rastet që nuk arriti t'i trajtojë gjatë ekzistimit të tij të mëparshme të jenë të fundit dhe të hetohen përfundimisht ose, nëse nuk janë, se Misioni duhet të ndërmarrë

hapa efektive që të kërkojë të adresojnë ose denoncojnë çështjen. Në dritën e detyrimeve të saj të vazhdueshme e ndaj të drejtave të njeriut, thjesht heshtja dhe pasiviteti nuk do të ofrojë ndonjë mjet juridik efektiv.

PËR KËTO ARSYE, PANELI NJËZËRI

GJEN që Misioni ka shkelur të drejtat themelore të ankuesit siç garantohet në nenet 2 (pjesa procedurale), 3 dhe 13 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut;

MË TUTJE GJEN se shkeljet janë serioze dhe të vazhdueshme dhe se ata, për këtë arsye, kërkojnë marrjen e masave korrigjuese në përputhje me to;

E GJEN TË PANEVOJSHME për të bërë gjetje sipas nenit 8 të Konventës;

FTON SHEFIN E MISIONIT, në veçanti, të marrë në konsideratë sa vijon:

- i. Të pranohet shkeljen e të drejtave të ankesës nga Misioni;
- ii. Të siguron një kopje të këtij vendimi për
 - a) organet përkatëse të Misionit,
 - b) autoritetet përkatëse politike në Bruksel dhe
 - c) autoritetet vendore kompetente për të hetuar këtë çështje;
- iii. Të urdhëron që kjo lëndë të monitorohet nga organet kompetente të Misionit;
- iv. Të pyeten autoritetet kompetente vendore se cilat hapa janë ndërmarrë, nëse ka pasur, për të hetuar këtë rast dhe cilat hapa të ardhshëm po planifikohen;
- v. Të kontaktohet ankuesi me qëllim që të gjeni një mënyrë për të korrigjuar shkeljen e të drejtave të saj.
- vi. Të informohet Panelin për çdo masë tjetër që konsiderohet e rëndësishme dhe e nevojshme nga Misioni për të përmbushur përgjegjësinë e tij për të korrigjuar shkeljet e të drejtave të njeriut të atribuara atij.

PANELI KËRKON NGA MISIONI të raporton mbi zbatimin e këtyre rekomandimeve dhe t'u përgjigjet pyetjeve të tij sa më shpejt që është e mundur, por jo më vonë se data 28 shkurt 2021.

Për Panelin

Guénaël METTRAUX
Kryesues

Petko PETKOV
Anëtar

Anna AUTIO
Anëtare

